

**Njoftim për përqendrim me të cilin Netcetera Group AG Cyrih , Zvicër, fiton kontroll të plotë mbi Procentric AG Zvicër**

**(lënda nr. 08-120/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 12.09.2022, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka pranuar njoftimin e përqendrimit me të cilin Netcetera Group AG me seli në Rr. Cypresenstrasse 71, Cyrih, Zvicër fiton kontroll të plotë mbi Procentric AG (Procentric AG) me seli të regjistruar në rr. Pionier nr.28, 8400 Vintertur (Pionierstrasse No.28, 8400 Winterthur) Zvicër, përmes shitblerjes së pjesëve.

Netcetera Group AG ofron shërbime të shoqërisë së informatikës dhe zhvillimin e produkteve digjitale.

Netcetera Group AG tashmë zotëron 32% të pjesëve në Procentric AG, dhe duke lidhur Marrëveshjen e blerjes së pjesëve me Bernard Ruh dhe Mark Shulc, do të fitojë pjesën e mbetur prej 68%, të cilat aktualisht nga 34% i kanë Bernard Ruh dhe Mark Shulc.

Netcetera Group AG është një kompani softuerike e themeluar në vitin 1996 me seli në Cyrih, Zvicër. Oferta kryesore që Netcetera ofron për tregun e përdoruesve është zhvillimi i teknologjisë së informatikës (TI) me shërbime të ndryshme TI dhe produkteve digjitale.

Netcetera Group AG është prezentë në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut si themelues i vetëm i shoqërisë me pjesëmarrje prej 100%: Netcetera SHPKNJP Shkup me seli në Rr. Partizanski Odredbi nr. 72 A, 1000 Shkup dhe objekt i punës është programimi kompjuterik. Gjithashtu, Netcetera Group AG është prezentë në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut si ortak në shoqërinë në vijim me pjesëmarrje prej 30%: Blokvers SHPK Shkup, me seli në Rr. "Ankarska" nr. 18/1 A, 1000 Shkup dhe objekt i punës është programimi kompjuterik.

Procentric AG është një kompani relativisht e vogël softuerësh që është e fokusuar në procese të specializuara dhe ofron shërbime të kombinuara përkatëse në ato fusha të specializuara. Selia e kompanisë është në Vintertur, Zvicër.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

13.09.2022

Shkup